



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE**  
**SEKTORI I NDIHMËS DHE KOORDINIMIT TË INFORMACIONIT**

Nr. 1363 Prot.

Tiranë, më 24 .04 .2026

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 3531/1 PROT., DATË 06.01.2026 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI KOLË KOLAJ"**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga z. Kolë Kolaj me nr. 1876 prot., datë 09.07.2024, në të cilën ngrihen pretendime për veprimtarinë e magjistratit F.G., me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Lezhë, në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 3531/1 prot., datë 06.01.2026, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Kolë Kolaj", bazuar në nenin 121, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar ka vendosur arkivimin e saj. Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë brenda 1 jave nga marrja e njoftimit.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e deklaruar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Lezhë, sipas adresës së ankuesit, Lezhë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al)

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Dëshira Pasko**

